



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:089171
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05278622

Ac.nr.5027/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbarimore të kreditorit Rr.H., nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë avokatët B.J., dhe A.J., nga Prishtina, ndaj debitorit N.N.T. “N.....-A”, me seli në Gjilan, Rr. “I..... P.....”, nr.49, me pronar R.Th., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.B., avokat nga Suhareka, me baze juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.61/2021 të datës 10.06.2022, më datë 02.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e pathemeltë ankesa e debitorit N.N.T. “N.....-A”, me seli në Gjilan, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.61/2021 i datës 10.06.2022, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin e atakuar CPK.nr.61/2021 të datës 10.06.2022, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e datës 02.04.2021, i debitori N.N.T. “N.....-A”, me seli në Gjilan, Rr. “I..... P.....”, nr.XX, kundër urdhrin përmbarimor P.nr.159/21 të datës 15.03.2021, të përmbarueses private Rr.M., nga Prishtina. Në pikën dy, ka mbetur në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.159/21 i datës 15.03.2021.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e paraqitur nga debitori, të shfuqizoj aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.61/21 të datës 10.06.2022, si dhe urdhrin përmbarimor

duke përfunduar kështu procedurën dhe të anuloj të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë ose lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i kreditorit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit, të refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.61/21 të datës 10.06.2022, të vërtetoj si të bazuar dhe të ligjshëm.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

- Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues-Aktit noterial, Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit kolektiv afaristo-biznesor LRP.nr.XXX/2014, Ref.nr.XX/2014 e datës 28.02.2014, e përpiluar pranë noteres S.K., me seli në Prishtinë, si dhe aneksit të kësaj kontrate LRP.nr.XXX/XX Ref.XX/XX e datës 22.04.2015. Përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin P.nr.XXX/21 të datës 15.03.2021. Ndaj këtij urdhri, debitori ka paraqitur prapësim me datën 02.04.2021, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit me datë 12.04.2021. Gjykata Themelore në Gjilan, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 të LPK-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 357 i LMD-së.

Gjykata ankimore vlerëson se aktvendimi i atakuar është nxjerr me shkelje të dispozitave të procedurës dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dokumentin përmbartues dhe përmbajtjen e tij. Sipas Kontratës për ndërtimin e përbashkët të objektit kolektiv afaristo-biznesor, përkatësisht aneksit LRP.nr.XXX/2015 Ref.XXX/2015 e datës 22.04.2015, është ndryshuar-precizuar neni VIII i kontratës bazë, ashtu që palët janë pajtuar që afati për përfundimin e punëve dhe dorëzimin e objekteve që ju takojnë pronarëve të tokave do të jetë data 30.06.2017, dhe se pas këtij afati, investitori do të paguaj dëmshpërblim nga 3000 euro, për secilin pronar të tokës për secilin muaj deri me datën 30.10.2017, ndërsa në rast të mos dorëzimit të objekteve pronarëve pas datës 30.10.2017, kjo kontratë konsiderohet e shkelëtur, dhe palët kanë të drejtë ti drejtohen gjykatës apo secilit organ tjetër kompetent për zgjedhjen e saj. Në rastin konkret, gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë përmbajtjen e dokumentit përmbartimor dhe atë se çka kërkohet të përmbartohet, pasi që sipas propozimit për përmbartim kreditori ka kërkuar dëmshpërblim për

periudhën prej datës 30.06.2017 e deri me datën 30.01.2021, ndërsa periudha pas datës 30.10.2017, nuk gjen mbështetje në dokumentin përmbartimor, ndërsa sipas dokumentit përmbartimor në rast të mos dorëzimit të objekteve pronarëve pas datës 30.10.2017, kontrata konsiderohet e shkëputur.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh pretendimet e paraqitura në prapësim nga debitori lidhur me parashkrimin e kërkesës sipas dispozitave të LMD-së, dhe se lidhur me këtë pretendim nuk ka dhënë ndonjë arsytim nëse kërkesa është parashkruar apo jo, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 357, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*. Në këtë rast kreditori ka qenë në dijeni për dëmin dhe për personin i cili e ka shkaktuar dëmin dhe se i njëjti kërkesën për dëmshpërblim ka mundur pa parashtraj menjëherë pas përfundimit të afatit sipas dokumentit përmbartimor. Andaj nga të cekurat u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj prapësimin dhe thëniet në prapësim, duke vlerësuar kështu në mënyrë të drejtë dokumentin përmbartimor dhe përmbajtjen e tij, në rast të paqartësisë të hap seancë dëgjimore duke ftuar palët që të deklarojnë rreth pretendimeve të tyre të sa i përket përmbushjes së kontratës, e po ashtu, të vlerësoj edhe pretendimet për parashkrim të kërkesës e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së lidhur me nenin 209 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
Ac.nr.5027/2022, më datë 02.02.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti